

PRESS/INFO
ORGES & THE OCKUS-ROCKUS BAND
„EXPORT - IMPORT!“ 2014



Export - Import!
... Hajde, Hopala!

Mbas suksesit me albumin e parë „Aheng,aheng!“, grupi „Orges & The Ockus - Rockus Band“ rikthehet sërish në skenën e „World Music“ me prezantimin e albumit të tyre të dytë me titull „Export - Import!“

Ky Band (formacion) i përzierë Shqipëtaro-Austriak, lëviz midis stilit Ballkanik, Western & Gipsy-Swing, Rock,n'Roll, Blues & Jazz dhe mund të përmblihet në një fjalë të vetme përsa i përket këtij stili original, BALKANBILLY.

„O.O.R.B“ u krijua në vitin 2008 nga kitarristi dhe kantautori Shqipëtar Orges Toçe.

Në Bateri- Christian Eberle dhe në Kontrabas- Lukas Kranzelbinder. Një Trio që ia vlen të të dëgjohet për muzikën, tekstet politiko-shoqërore dhe atmosferën „motorrike“ që kjo Trio luan. Fare mirë mund të thuhet; DUKE GODITUR „TROÇ“ e në mënyrë krejt PUNK nëpërmjet teksteve, me qëllimin për ti lënë vend asaj dëshire tepër të madhe për një jetë sa më përsëmbari dhe të drejtë!

... Dhe aty diku në mes të publikut krejt të çakërdisur, mund të endesh ose gjëndesh fare qetë me një shishe RAKIE në dorë, një Rritëm, një Strofë apo Refren që të rrëmben. Haha... zgjidhja e vetme është të lëvizësh... Lëviz o njeri, kërce dhe hidhu sa andej - këndeje, me pak fjalë „SHKUNDI ENERGJITË E KËSAJ BOTE KAQ MUT!!!“ Në fund të fundit ajo çfarë mbetet e bukur është JETA!

*... HA, PIJ, DEHU DHE BËJ SHUMË DASHURI,
NDRYSHE, JO S'KE GJË NË VIJË!
... NDAJ BËJ QEJF, O MILET! :)*

(Tekst i shkëputur nga kënga „Jetë Qeni“ / CD: Export-Import!“ 2014)

Shtëpia discografike
Shitja

Toçe Records
iTunes

Band: Orges Toçe – Vokal, Kitarrë
Christian Eberle - Bateri
Bernd Satzinger – Kontrabas

www.oorb.net

Kontakt Orges Toçe, booking@oorb.net, +43 (0) 699 11 55 70 16